



Specifikimet Teknike për “Blerja dhe instalimi i infrastrukturës së furnizimit me energji elektrike dhe transmetimit të dhënave me fibër optike”



PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA.....

Hyrje.....

Konfidencialiteti.....

1. Te Pergjitheshme

1.1 Gama e Furnizimi

Ofertuesit do të ofrojnë shërbimet si vijon.....

2. Specifikime Teknike te sistemit te energjise

3. Specifikime Teknike te fibres



Hyrje

Albcontrol është përgjegjës për shërbimet e navigimit ajror në Republikën e Shqipërisë. Për të realizuar misionin e vet Albcontrol, instalon, mirëmban dhe operon sistemet e menaxhimit të trafikut ajror në lidhje me komunikimin, navigimin dhe survejimin e hapësirës në të cilën sigurohet ky shërbim. Këto sisteme janë vendosur në stacione të ndyshme brenda dhe jashtë ambjenteve të Albcontrol. Në këtë kuadër të mbarëvajtjes së hapësirës ajrore të Shqipërisë shikohet e domosdoshme që në Aeroportin Ndërkombëtar të Vlorës i cili ndodhet në fazën e ndërtimit, nga Albcontrol të instalohen sistemet elektrike dhe ato të fibrave optike sipas specifikimeve dhe skemave të paraqitura më posht duke siguruar në këtë formë një operim më të sigurt në lidhje me furnizimin me energji dhe shkëmbimin e të dhenave të Site-ve që do të gjenden në pistën e VIA (Vlora International Airpor).

Konfidencialitet

I gjithë Informacioni i marrë nëpërmjet kësaj procedure është pronë e Albcontrol dhe ofertuesit nuk mund ta përdorin apo shpërndajnë tek të tretë përveçse për nevojat e përmbushjes dhe plotësimit të ofertës së tyre.

Po kështu ofertat e dorëzuara në Albcontrol do të trajtohen si konfidenciale dhe nuk do të shpërndahen tek të tretë jashtë Albcontrol.



1. Të Përgjithshme


Sistemi i transmetimit të të dhënave dhe ai elektrik janë sisteme kritike në operimin dhe ecurinë e paisjeve që ndodhen në Aeroportin Ndërkombëtar të Vlorës (VIA). Si i tillë duhet ti kushtohet një rëndësi e veçantë funzizimit dhe instalimit bashkëkohor dhe me standarde më të larta për të bërë të mundur operimin sa më të qëndrueshëm dhe të sigurtë të këtyre sistemeve duke patur gjithmonë në vëmendje faktin se këto sisteme duhet të punojnë pa ndërprerje 24 orë në 7 ditë të javës.


Me funzimin dhe instalimin e sistemeve të cilat janë pjesë e kësaj procedure, do të bëhet i mundur furnizimi i qëndrueshëm me energji dhe shkëmbimi i të dhënave me pajisjet që gjenden në Sitet e vendosura në brendësi të pistës së Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës (VIA) dhe kullës së kontrollit.

Ambjentet që do të furnizohen me energji elektrike dhe fiber komunikimi janë :

- Site IIs veri & jug
- Site Glide slope veri & jug
- Kopshtet meteorologjike veri dhe jug
- Matesi reve veri & jug
- Sistemi matesit të erez

Në mënyrë skematike po ju paraqesim idenë e furnizimit të siteve me energji dhe pozicionin e tyre në pistë







Bazuar në sa u përmend më lart si dhe në rëndësinë e shërbimit të Albcontrol si kompani ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të përpiktë të gjitha specifikimet për sistemin elektrik dhe sistemin e transmetimit të të dhënave që gjenden bashkëngjitur këtij materiali.

1.1 Gama e Furnizimit , vendosjes dhe testimeve

Ofertuesit do të ofrojnë shërbimet furnizim vendosje si vijon:

NR	Pershkrimi	Njesia
1	Kabine parafabrikate betoni e lyer sipas kekresave ICAO	cp
2	Cele seksionues me thike	cp
3	Cele me sigurese	cp
4	Sigurese TM	cp
5	Transformator me vaj 6/0.4 kv 50kva	cp
6	Transformator me vaj 6/0.4 kv 30kva	cp
7	Terminal TM 6Kv te brendshem	kit
8	Kapikorda baker *alumin fi 50	cp
9	Kapikorda baker fi 70	cp
10	Kapikorda bakri fi 50	cp
11	Kapikorda bakri fi 35	cp
12	Shirit Bakri Cu 20x3 mm	ml
13	Percjelles baker Cu zhveshur 95mm2	ml
14	Morsete pjaster katror baker Cu	cp
15	Elektrode tokezimi 1.5 baker Cu d16 me filete	cp
16	Manikote me filete per elektrode baker Cu d16	cp
17	Morsete katrore d16 cu	cp
18	Material per eksplozim Cu dhe Zn per te lidhur elektroden me litarin Cu	cp
19	Kabell FG16OR16 3*70+1*35	ml
20	Kabell FG16OR16 3*50+1*25	ml
21	Kabell FG16OR16 3*2,5	ml
22	Kabell FG16OR16 4*25	ml
23	Kabell FG16OR16 3*1,5	ml
24	Morset suport shirit Baker Cu komplet me vide dhe upe M6	cp
25	Ndricues hermetik 2 x 36w	cp
26	Pllafon ip65	cp
27	Llampe sinjalizimi per naten Aircraft Warning Light	cp




28	Tub rigid plastik fi 20 kompletuar me grapeta upa vida	ml
29	Kuti jm ip 40 3 mod	cp
30	Celes 1P 10A	cp
31	Prize shuko 16A	cp
32	Kuader jm ip 40 100 mod kompletuar sipas skemes elektrike	cp
33	Komutator me tre pozicione 100 a 4p	cp
34	Sensor nate dite16a	cp
35	Tub korogato me dy veshje fi 100	ml
36	Hapje kanali 100 cm te thelle ne dhe trajtuar me rere dhe shirit sinjalizues per kablo te TU	ml
37	Puseta betoni 30 x 3 me kapak gize	cp
38	Kabell TM 6KV Al XLPE 1 X 50 mm2	ml
39	Zgjatues 16A 220v me 6 fole	cp
40	STS 32A 220V kohe zero	cp
41	Centralino me komunikim ne distance	cp
42	FV - Fiber Optike 12 Fije Single mode	ml
43	FV – Patch panel 24 port rack mount	cp
44	FV - Patch panel 24 port wall mount	cp
45	FV - Patch panel 12 port wall mount	cp
46	FV Xhunto FO per Fiber me 12 Fije	cp
47	Patch FO SC-SC 2m	cp
48	Patch FO SC-LC 2m	cp
49	Patch FO SC-SC 5m	cp
50	Patch FO SC-LC 2m	cp
51	Patch FO SC-SC 10m	cp
52	Patch FO SC-LC 10m	cp
53	Patch FO SC-SC 20m	cp
54	Patch FO SC-LC 20m	cp
55	Switch Industrial Sipas Specs	cp
56	SFP per FO Single Mode per Switchet	cp

Çelat e TM me gaz SF6

Cela e linjës hyrëse me ndarës ngarkese me gaz SF6 dhe cela e mbrojtjes së transformatorit me ndarës ngarkese me gaz SF6 dhe siguresa TM.

- Cela e linjës me ndarës ngarkese me gaz SF6 përmban ndarësin e ngarkesës me gaz SF6, thikën e tokëzimit, përçuesit dhe zbarat lidhëse; terminalet e TM janë të sheshta për lidhjen e kabllave njëdejtës.
- Cela e transformatorit me ndarës ngarkese me gaz SF6 dhe siguresa. Cela përmban ndarësin e ngarkesës me gaz SF6, thikën e tokëzimit, siguresat, përçuesit dhe zbarat lidhëse; terminalet e TM janë të sheshta për lidhjen e kabllave njëdejtës.

Skema elektrike njëvijëshe:



Ilustrimi
(Ilustrimi dhe dimensioned janë orienruese)



Shtrirja e furnizimeve dhe shërbimeve

Ky specifikim përfshin testimin, prodhimin, transportin dhe montimin në terren të pajisjeve elektromekanike të mëposhtme:

1 CELAT NË KABINAT PARAFABRIKAT	
1.1	Çela e Linjës me Ndarës Ngarkese me Gaz SF6: • Ndarës ngarkese me izolacion me gaz SF6, që siguron ndarje dhe izolim të sigurt të qarqeve elektrike. • Thikë tokëzimi, për mbrojtje elektrike dhe siguri gjatë mirëmbajtjes. • Përçues dhe zbarat lidhëse, për transmetimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike. • Termialet e TM, të dizajnuara në formë të sheshtë për lidhjen e kablove një-dejesh. Ky konfigurim garanton funksionim të sigurt dhe efikas të sistemit të energjisë elektrike.
1.2	Çela e Transformatorit me Ndarës Ngarkese SF6 dhe Siguresa përfshin komponentët e mëposhtëm: • Ndarës ngarkese me izolacion me gaz SF6. • Thikë tokëzimi për siguri dhe mbrojtje elektrike. • Siguresa, për mbrojtjen nga mbingarkesa dhe qarku i shkurtër. • Përçues dhe zbarat lidhëse, për ndërlidhjen dhe transmetimin e energjisë elektrike. • Termialet e TM, të dizajnuara në formë të sheshtë për lidhjen e kablove një-dejesh. Ky konfigurim siguron funksionalitet, siguri dhe besueshmëri të lartë në operimin e transformatorëve.



Pjesë e furnizimit janë të gjitha skemat dhe diagramat e nevojshme, duke përfshirë:

- **Skemat dhe diagramat konstruktive** të kërkuara për prodhim dhe testim.
- **Instruktionet e mirëmbajtjes** për garantimin e qëndrueshmërisë dhe funksionimit.
- **Instruktionet e përdorimit**, për operimin e sigurt dhe efikas të pajisjeve.

Të gjitha furnizimet duhet të jenë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara.

Standartet

Furnizimi, montimi, materialet dhe testimi i kryer sipas kësaj kontrate duhet të plotësojnë standardet **IEC** të përmendura në specifikimet teknike të detajuara.

- **Materialet Fiksuese**

Materialet fiksuese, duke përfshirë:

- **Bullonat,**
- **Dado,**
- **Rondelet,**
- **Vidat,**

duhet të jenë në përputhje me standardin **DIN**.

- **Cilësia e Materialeve**
- Materialet duhet të jenë **të reja** dhe të **cilësisë së parë**.
- Duhet të jenë të përshtatshme për qëllimin për të cilin përdoren.
- Duhet të përmbushin kërkesat e **klasifikimit** dhe **klasës së cilësisë**, në përputhje me botimet më të fundit të standardeve **ASTM**, **DIN**, ose ekuivalente me to.

Specifikime teknike të detajuara

- **Kërkesat dhe Përputhshmëria me Standardet**
- Kërkesat specifike të aplikueshme për pajisje të ndryshme duhet të përmbushin **standardet IEC** sipas publikimeve më të fundit ose ekuivalentet e tyre.
- Pajisjet duhet të jenë në përputhje me standardet për siguri dhe performancë për të siguruar operim të sigurt dhe efikas.
- **Çelat 6 kV** do të përdoren në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike.
- Vetëm **materialet e cilësisë së lartë** do të pranohen për furnizim dhe instalim.
- Pajisjet do të montohen në **Stacionet e Transformimit** (kabinat parafabrikat) 6/0.4 kV, duke respektuar standardet përkatëse IEC.
- **Kërkesat për Instalimin**
- Të gjitha pajisjet dhe materialet duhet të jenë të përshtatshme për montim të brendshëm dhe të ofrojnë lidhje kabllorë nga poshtë, sipas projektit të miratuar.
- Pajisjet duhet të sigurojnë:
 - Qëndrueshmëri ndaj kushteve të ambientit të brendshëm.
 - Besueshmëri të lartë në operim dhe mirëmbajtje minimale



Të dhëna teknike

Çela e linjës me ndarës ngarkese me SF6 (panel with SF6 load switch disconnecter).

Tensioni me i larte i sistemit	kV	7.2
Vlera e tensionit nominal	kV	6
Rryma nominale ne zbare	A	630
Rryma nominale ne fider	A	630
Rryma nominale ne lidhje te shkurter (1 sec.)	kA	16
Vlera e tensionit impulsiv te qendrueshmerise ndajshkarkimeve	kV	60
Vlera e tensionit te qendrueshmerise per frekuencen 50 Hz	kV	50
Shkalla e mbrojtjes		IP 4X

Testet fizike dhe elektrike të pranimit do të bëhen ne përputhje me standartet IEC.

Permasat orientuese jane:

Lartesia	mm	2200 max
Thellesia	mm	1100 max
Gjeresia	mm	600 max

Ndërtimi dhe materiali

Paneli do të ketë një shkallë mbrojtjeje të përgjithshme **IP 4X**.

Të gjitha pjesët e çelikut do të trajtohen me proces pastrimi, heqjeje të grasos dhe fosfatimi.

Pjesët përbërëse do të ndërtohen me fletë çeliku të galvanizuar me trashësi jo më të vogël se **3 mm** dhe të përforcuar, në mënyrë që të jenë të sigurt dhe të mos deformohen edhe në kushtet më të vështira të punës.

Në pjesën fundore, paneli duhet të pajiset me korniza për t'u fiksuar në dyshtemenë prej betoni.

Panelet do të pajisen me dritare për të monitoruar çelësin e ngarkesës, pozicionin e thikës së tokës dhe çdo të dhënë të rëndësishme.

Paneli duhet të shmangë kondensimin.

Siguria e personelit do të garantohet me kyçje të thjeshtë manuale që parandalon çdo mundësi përdorimi të gabuar. Dera është e ndërthurur me bllokim mekanik me thikën e tokës.

Sistemi i zbarave do të montohet në ndarjen e duhur të panelit, në mënyrë që të mundësohet lidhja e saktë e të gjitha pajisjeve ndërmjet terminaleve të kablllove hyrës dhe dalës.

Sistemi i zbarave do të dimensionohet, rregullohet dhe fiksohet në atë mënyrë që t'i rezistojë dinamikës së pikut të rrymës së lidhjes së shkurtër, pa transmetuar tension shtesë në izolatorët dhe pjesët e tjera të panelit.

Indikatorët e tensionit për çdo fazë duhet të jenë tregues kapacitivë.

Cela duhet të jetë e pajisur me sinjalizim vizual për presionin e lejuar të gazit. Ajo duhet të ketë një tregues me ngjyra, ku:

- Ngjyra **jeshile** tregon se pajisja është në gjendje për të operuar.



- Ngjyra e kuqe tregon se pajisja nuk duhet të operojë.

Paneli metalik duhet të jetë me etiketë, në përputhje me **Standardin IEC 298**.

Dyert e panelit duhet të pajisen me sistem bllokazhi me qëllim që të mos hapen pa u marrë të gjitha masat e sigurisë si heqja e tensionit, tokëzimi, etj.

Çdo panel do të jetë i llojit vetëmbështetës, i paintegruar (i veçuar), që të ofrojë lehtësisht akses për punë, inspektim dhe mirëmbajtje nga ana ballore.

Të gjitha materialet për të fiksuar panelin në dyshtemenë prej betoni do të konsiderohen si të përfshira në furnizim.

Ndarësi i ngarkesës do të pajiset me një mekanizëm që vihet në punë në mënyrë manuale.

Ndarësit do të jenë të llojit “**me veprim të shpejtë**”, me pjesë të dimensionuara lirshëm.

Projektimi i ndarësit të ngarkesës duhet të bëjë të mundur mirëmbajtjen e kontakteve të lëvizshme dhe të palëvizshme, si dhe një kontroll të thjeshtë të tyre.

Kontaktet do të jenë të mbuluara me një shtresë argjendi ose do të kenë një mbrojtje ekuivalente.

Thika e tokëzimit duhet të montohet në ndarjen e kabllit. Për arsye sigurie, duhet një indikator tregues për pozicionin e ndarësit të ngarkesës dhe thikës së tokëzimit.

Ndarësi i ngarkesës dhe thika e tokëzimit kanë bllokim mekanik midis tyre.

Siguresat TM

Përshkrim, kërkesa dhe të dhëna

Ky specifikim mbulon kërkesat e siguresave TM, të përshtatshme për instalime të brendshme.

Të dhëna teknike

1	Tensioni nominal	6 kV
2	Tensioni me I larte I sistemit	7.2 kV
3	Numri I fazeve	3
4	Frekuenca nominale	50 Hz
5	Rryma nominale (I_N) per TR 50KVA	4.8A
6	Rryma ne lidhje te shkurter per 1 sec.	16 kA
7	Rryma maksimale qe percjell (piku)	40 kA
8	Tensioni qe duron ndaj shkarkimeve ne 1.2 / 50 ms	60 kV
9	Tensioni qe duron ne frekuence te fuqise	50 kV

Rryma nominale e fillit shkrires të siguresës per trasformatorët e shperndarjes zgjidhet sipas tabelës se me poshtme:

	Fuqia e transformatorit (kVA)	
	50	30
	Rryma nominale e fishekut te siguresë (A)	
6	10 - 16	10 - 16
10	10	10



Ndërtimi dhe Materiali i Siguresave TM

Siguresat TM duhet të kenë aftësinë për të mbrojtur transformatorin e fuqisë nga **rrymat e lidhjes së shkurtër**. Ato duhet të kenë një ndërtim të tillë që të përmbushin kërkesat e mëposhtme:

1. **Qëndrueshmëri ndaj rrymave të lidhjes së shkurtër.**
2. **Rezistencë të mjaftueshme ndaj kushteve të ambientit**, si temperatura, lagështia dhe pluhuri.
3. **Jetëgjatësi e lartë**: Pjesët përbërëse të siguresës nuk duhet të plaken ose të degradohen shpejt.
4. **Standardizim**: Ndërrimi i siguresave duhet të jetë i mundur me siguresa të prodhuara sipas **standardit ndërkombëtar (IEC 60282-1)**.

Furnizuesi duhet të paraqesë **karakteristikën rrymë-kohe**, e cila tregon varësinë midis **rrymës** që kalon në siguresë dhe **kohës** së ndërprerjes së saj:

- **Për rrymë 130% të vlerës nominale**: Fillimi shkrirës **nuk duhet të shkrijë për një orë**.
- **Për rrymë 200% të vlerës nominale**: Shkrirja duhet të ndodhë **brenda më pak se një orë**.

Materiali dhe Komponentët e Siguresave

- a) **Fishekët e siguresave**:
 - Duhet të prodhohen nga **porcelan cilësor**, me sipërfaqe **të lëmuar** dhe **të shkëlqyeshme**, për të siguruar izolim të mirë elektrik dhe rezistencë mekanike.
- b) **Kontaktet e fishekut (xokolat)**:
 - Të realizuara me **bakër elektrolitik**, të mbrojtura **galvanikisht** për të shmangur oksidimin dhe për të siguruar kontakt të qëndrueshëm elektrik.
 - Kontaktet duhet të jenë **hermetikisht të vendosura** në kanalën e tubit të siguresës, duke siguruar rezistencë ndaj konsumimit dhe temperaturave të larta.
- c) **Elementi shkrirës**:
 - Duhet të jetë i ndërtuar me **argjend të pastër**.
 - Preferohet që siguresa të ketë **shumë elemente shkrirës** të lidhur paralelisht, për të arritur **trashësi më të vogël** të secilit element dhe shpërndarje më të mirë të rrymës.
- d) **Mekanizmi sinjalizues**:
 - Siguresa duhet të jetë e pajisur me një **mekanizëm sinjalizues**, që jep informacion mbi **gjendjen e siguresës** dhe funksionimin e mekanizmave ndihmës si **ndarësi i ngarkesës**.
- e) **Izolatorët mbështetës të bazamentit**:
 - Duhet të jenë të prodhuar nga **porcelani** ose **material epoksi**, për të garantuar izolim dhe qëndrueshmëri mekanike.
- f) **Fashetat (fiksuesit)**:
 - Duhet të jenë prej **bakri elektrolitik të zinkuar**.
 - Të kenë **elasticitet të lartë mekanik**, për të siguruar **rezistencë të ulët të kontaktit** dhe qëndrueshmëri ndaj forcave mekanike.
- g) **Pjesa metalike e bazamentit**:
 - Duhet të prodhohet nga **çelik i galvanizuar**, për të siguruar rezistencë ndaj korrozionit dhe jetëgjatësi të lartë.



Trasformator Fuqie 50kVA dhe 30 kVA, 0.4/6 kV

Kërkesa të detyrueshme

Është e detyrueshme që furnizuesi të sigurojë të dhëna teknike (pjesë e specifikimeve teknike) si pjesë integrale e propozimit të tyre:

- Certifikatat e prodhimit **ISO 9001**
- Të dhëna teknike të plotësuar sipas kërkesave më poshtë
- Katalogu i produktit
- Emri i llojit dhe vendi i prodhimit
- Përshkrime teknike, duke përfshirë parametrat dhe aksesoret e garantuar
- Skemat me dimensione, duke përfshirë vendndodhjen dhe përshkrimin e terminaleve të përfshirë në mbulesë
- Përshkrimi në pllakën identifikuese
- Pesha e vajit
- Jetëgjatësia (vite)
- Udhëzime për përdorim, vënie në punë dhe mirëmbajtje
- Sistemi i kontrollit të cilësisë dhe certifikatat përkatëse
- Protokolli i testeve dhe lista e testeve të kryera
- Deklarimi për mungesën e PCB
- Duhet të ketë markim **CE**

Transformatori i shpërndarjes do të jetë transformator i mbushur me vaj të tipit të mbyllur hermetikisht **ONAN**.

Transformatorët do të kenë vlerë nominale të tensionit prej **0.4/6 kV**.

Regullatori i tensionit, i cili vendoset në anën TM, do të jetë **plus-minus 5%** me **2.5%** në çdo shkallë.

Transformatori i fuqisë do të jetë i ndërtuar në atë mënyrë që të përmbushë kërkesat e mëposhtme:

- Të sigurojë shpërndarje efikase të nxehtësisë.
- Të jetë i papërshkueshëm nga uji dhe vaji i nxehtë.
- Të ketë zhurma dhe dridhje deri në një nivel të lejueshëm.
- Jetëgjatësia teknike duhet të jetë **30 vjet**.

Specifikime reference

Transformatorët duhet të furnizohen dhe testohen në përputhje me specifikimet e Komisionit Ndërkombëtar Elektroteknik:

- Insulation coordination – **IEC 71**
- Power transformers – **IEC 76**
- Bushings for alternating voltages above 1000 V – **IEC 137**



- Dimensions of tubes, pins, and rods of ferromagnetic oxides – **IEC 220**
- Tests on hollow insulators for use in electrical equipment – **IEC 233**
- Partial discharge measurements – **IEC 270**
- Specification for unused mineral insulating oils for transformers and switchgear – **IEC 296**
- Degrees of protection provided by enclosures (IP Code) – **IEC 529**
- Determination of transformer and reactor sound levels – **IEC 551**
- Specification for structural steel – **ASTM A36**

Përcaktimet e dhëna më sipër, sipas publikimeve të IEC, do të aplikohen më poshtë.

Në rast se kërkesat e mëposhtme ndryshojnë nga ato të dhëna në specifikimet e IEC të përmendura më sipër, në një fushë të veçantë, transformatorët duhet të plotësojnë kërkesat e listuara sipas këtij artikulli.

Për këtë qëllim, skemat dhe llogaritjet do të kryhen sipas sistemit SI.

Përshkrim i pjesëve përbërëse të transformatorit

Nukli i transformatorit

Konstruksioni i qarkut magnetik duhet të jetë i tillë që të shmangë zhvillimin e shkarkimeve statike të lidhjes së shkurtër në konturin e brendshëm ose në strukturën fiksuese të tokëzuar dhe prodhimin e komponentit të fluksit pingul me fletën e çelikut të petëzuar.

Çdo fletë e petëzuar duhet të izolohet me material të qëndrueshëm në kushtet e punës.

Qarku magnetik duhet të tokëzohet nëpërmjet një lidhjeje testuese të heqshme me konstruksionin metalik, e vendosur në një pozicion të favorshëm.

Nukli i transformatorit do të prodhohet prej çeliku të cilësisë së lartë me kristale të orientuara. Ai duhet të jetë i përbërë nga fletë çeliku të petëzuara, dhe çdo fletë duhet të jetë e izoluar me llak të përshtatshëm për të shmangur humbjet nga rrymat fuko.

Nukli do të mbështetet në bazament nëpërmjet fiksuesve të izoluar dhe do të tokëzohet nëpërmjet një lidhjeje të heqshme.

Nukli (fletët e llamarinës) do të jetë i mbrojtur ndaj gjërryerjes duke u lyer me një shtresë llaku me trashësi të paktën 1 mm.



Pështjellat

Transformatorët do të kenë pështjella bakri elektrolitik me përçueshmëri të lartë. Materiali i izolimit duhet të jetë i **Klasës A** (sipas **IEC 76-2**).

Izolimi i pështjellave dhe lidhjet duhet të jenë të lira nga përbërës që mund të shkaktojnë tkurrje ose këputje gjatë shfrytëzimit. Pështjellat do të ndërtohen me shirita bakri në vend të përçuesve, për të arritur qëndrueshmëri të lartë ndaj lidhjeve të shkurtër në anën e tensionit të ulët.

Transformatori duhet të ketë izolim të **Klasës A** ose më të mirë. Pështjellat mund të izolohen me letër izoluese ose llak, në përputhje me standardet e prodhuesit.

Ndërtimi i pështjellave duhet të jetë i tillë që të sigurojë një shpërndarje të njëtrajtshme të tensioneve impulsive dhe tensioneve të shkarkimeve, duke shmangur pikat e dobëta në izolim.



Kazani

Kazani i transformatorit duhet të prodhohet nga material me trashësi dhe fortësi të tillë që të rezistojë pa u dëmtuar ose mbinxehur në kushtet e punës ose gjatë lidhjes së shkurtër. Transformatori do të jetë pa zgjerues vaji. Për kazanin dhe pjesët e tjera, preferohet të përdoren konstruksione të salduara.

Sistemi ftohës i transformatorit duhet të jetë me fletë llamarine në pjesët anësore të depozitës. Transformatori duhet të pajiset me rrota që lëvizin në të dyja drejtimet, për lehtësimin e instalimit në objekt.

Rregullatori i tensionit

Rregullatori i tensionit duhet të sigurohet nëpërmjet një çelësi dhe të vendoset në një vend të përshtatshëm (mbi kapak) për t'u manovruar lehtësisht.

Rregullatori i tensionit duhet të pajiset me një çelës rregullues me dorezë të jashtme rrotulluese, që siguron bllokimin e rregulluesit në pozicionin e zgjedhur.

Mekanizmi duhet të jetë i pozicionuar jashtë transformatorit për manovrim të lehtë. Pozicionet e rregullatorit të tensionit duhet të shënohen qartë dhe të jenë të qëndrueshme me kalimin e kohës. Pozicionet që korrespondojnë me vlerën e rregullimit të rregullatorit duhet të stampohen ose të gdhenden në një pllakë metalike treguese, e fiksuar në kapakun e transformatorit.

Çelësi i rregullatorit të tensionit duhet të jetë i ndërtuar në atë mënyrë që të shmangë mundësinë e vendosjes së rregullatorit në një pozicion të ndërmjetëm.

Lidhja e rregullatorit të tensionit me kapakun e transformatorit duhet të jetë e tillë që të eliminojë rrjedhjen e vajit gjatë shfrytëzimit.

Terminalet

Terminalet e kabllave të transformatorit duhet të projektohen duke pasur parasysh llojin e lidhjeve të përshkruara më poshtë:

- **Në TM:** kablllo alumini të izoluar
- **Në TU:** kablllo alumini të izoluar

Tipi i pllakave përshtatëse, tip flamur, është dhënë në aneksin 1.

Daljet e pështjellave nga brenda jashtë transformatorit duhet të realizohen me anë të izolatorëve kalimtarë prej porcelani me ngjyrë kafe. Izolatorët duhet të jenë të përshtatshëm për përdorim në ambiente të jashtme.

Instrumentet dhe aksesoret

Transformatorët duhet të pajisen, të paktën, me instrumentet dhe aksesoret e mëposhtëm:

- Tregues i nivelit të vajit
- Termometër
- Ganxha për ngritje
- Tapë në pjesën e sipërme për mbushje me vaj
- Rubinet për kullimin e vajit në pjesën e poshtme
- Bulona për tokëzim në pozicion diagonal
- Rrota që lëvizin në dy drejtime
- Targë identifikuese
- Çelës i rregullatorit të tensionit
- Kapaku i tapës për mbushjen me vaj
- Bazamenti metalik për montimin e kazanit dhe të rrotave
- Shkarkues në formë bri
- Pllakatë në gjuhën shqipe, e vendosur në anën e tensionit të ulët



- Shkronja të dukshme dhe të përhershme mbi mbulesë në anën e tensionit të mesëm: **1U, 1V, 1W**; dhe në anën TU: **2U, 2V, 2W, 2N**
- Valvul sigurie ose ndonjë zgjidhje tjetër teknike për të parandaluar shkatërrimin e kazanit

Vaji izolues

Transformatori duhet të pajiset me sasinë e duhur të vajit izolues me përmbajtje minerale të cilësisë së lartë. Vaji duhet të jetë në përputhje me **Standardin IEC 296 (Class 11)**.

Të dhënat teknike të tjera për secilin tip të transformatorit të fuqisë janë treguar në shtesën 1 më poshtë. Grupi i lidhjes **Dyn 5** mund të jetë edhe **Dyn 11**.

Testet

Transformatorët e shpërndarjes duhet të testohen si më poshtë:

- Matja e rezistencës omike të mbështjellave në temperaturën 20°C
- Matja e rezistencës së izolimit të mbështjellave në temperaturën 20°C
- Matja e koeficientit të transformimit dhe grupit të lidhjes
- Provat e punimit pa ngarkesë
- Provat e lidhjes së shkurtër
- Provat me tension të rritur
- Matja e rrymave të rrjedhjes
- Matja e tangentës delta
- Matja e qëndrueshmërisë elektrike të vajit

Garancitë e kërkuara

Lidhja e shkurtër

Rezistenca e lidhjes së shkurtër dhe impedanca zero **Z0** nuk duhet të ndryshojnë më shumë se **10%** e vlerës së specifikuar.

Humbjet

Humbjet që tejkalojnë vlerat e garantuara, pas një tolerance prej **2%**, do të penalizohen si më poshtë:

- **Humbjet pa ngarkesë:** 400,000 ALL/kW
- **Humbjet me ngarkesë:** 150,000 ALL/kW

Transformatorët do të refuzohen nëse humbja totale tejkalon **5%** të vlerës së garantuar ose nëse humbjet pjesore tejkalojnë **10%** të vlerës së garantuar.

Nuk do të paguhet dëmshpërblim nga blerësi për humbjet brenda vlerave të garantuara të përcaktuara më poshtë.

Rryma pa ngarkesë

Toleranca e rrymës në punim pa ngarkesë duhet të jetë maksimumi **+30%** e vlerës së garantuar.

Raporti i tensionit

Toleranca në punim pa ngarkesë, kur rregullatori është në pozicionin kryesor për përshtjellën **TM/TU**, duhet të jetë **±0.5%** e raportit nominal të tensionit dhe më pak se **±0.7%** në pozicionet e tjera.

Fuqia nominale

Në secilën përshtjellë duhet të përcaktohet fuqia nominale, siç specifikohet. Këto përshtjella duhet të jenë të tilla që transformatori të funksionojë nën kushte të qëndrueshme të ngarkesës pa tejkaluar kufirin e specifikuar të rritjes së temperaturës.



Kapacitetet e mbingarkesës

Transformatori i fuqisë duhet të jetë në gjendje të ngarkohet në përputhje me udhëzuesin e ngarkesës sipas IEC. Vlerat në rregullatorin e tensionit ose pajisjet e tjera nuk duhet të kufizojnë këto mbingarkesa.

Në ofertë duhet të garantohen këto vlera, dhe blerësi ka të drejtë të refuzojë çdo pajisje që nuk është në përputhje me këto vlera.

Specifikimet teknike për transformatorët 50kVA dhe 30kVA, 0.4 /6kVA



NR.1		TR 50kVA, 0.4/6 kVA	TR 30kVA, 0.4/6 kVA
Pershkrimi	Njesia	50kVA	30kVA
Standartia aplikuar (Applied standard)		IEC 60076	
Tensioni nominal (Rated voltage)	kV	6/0.4 kV	
Fuqia nominale (Rated power (Sn))	kVA	50	30
Qendrueshmëria ndaj tensionit impulsiv (tensioni impulsiv që duron) (1.2/50 µs)	kV	60 kV (sipas standardit IEC 60076-3)	
Qendrueshmëria ndaj tensionit me frekuencën e fuqisë në TM (1 min.)	kV	20	
Qendrueshmëria ndaj tensionit me frekuencën e fuqisë në TU (1 min)	kV	3	
Rryma në primar	A	72,1	43.3
Rryma në sekondar	A	4.81	2.89
Grupi lidhjes		DNY-11	
Frekuenca nominale	Hz	50	
Shkallet e rregullimit në TM	%	± 2 x 2.5	
Tensioni LSH në 75 °C	%	90% - 95%	
Sistemi tokezimit në TM		I izoluar (isolated)	
Tensioni nominal në TU	V	400/230	
Numri fazeve në TM		3	
Numri fazeve në TU		3 faze/4 percjellesa	
Sistemi tokezimit në TU		Direct në toke	
Menyra e ftohjes (Type of cooling)		ONAN	
Rritja maksimale e temperaturës në pjesën e sipërme të vajit (	°C	70	70
Rritja maksimale e temperaturës së peshës në pjesën më të nxehur	°C	80	80
Max i vlerave të garantuara të humbjeve pa ngarkesë	W	130	110
Max i vlerave të garantuara të humbjeve të ngarkesës	W	1000	650
Pesha totale	kg	430	360
Pesha e vajit	kg	90	55



Kabina Parafabrikat



Kërkësa të përgjithëshme

Kontrata përmban , ndërtimin, prodhimin, testimin, transportin dhe montimin në aeroportin e Vlorës.








Prerja B-B




2



Prerje e bazamentit ne dimensionin 298 cm



Prerje e bazamentit ne dimensionin 4180 cm



Struktura mekanike dhe pjesët përbërëse të sajë

Trupi

Kabina duhet të realizohet me një strukturë monolite (me derdhje sipas metodës zanore) të përbërë nga beton i përforcuar (beton i armuar) me cilësi shumë të lartë, për të siguruar një sipërfaqe të sheshtë dhe homogjene. Ajo duhet të jetë me vetëmbajtje.

Kabina realizohet si një pjesë e vetme prej hekuri-betoni të përforcuar me cilësi shumë të lartë. Betonit që do të përdoret për realizimin e konstruksionit të kabinës BOX duhet t'i shtohet një lëndë e përshtatshme fluidifikante dhe e padepërtueshme, në mënyrë që të sigurohet hidroizolim i duhur dhe mbrojtje kundër depërtimit të ujit nëpër kapilarët.

Muret dhe bazamenti duhet të jenë prej betoni **C35**, ndërsa dyshemeja **C45** (specifikimet përkatëse përcaktohen nga llogaritjet). Në mure duhet të inkorporohen të gjitha pajisjet (përfshirë dado dhe bulonë) e nevojshme për montimin e panelit TU dhe sistemit të tokëzimit.

Muret e jashtme duhet të suvatohet me llaç plastik me madhësi të kokrrës 2 mm.

Muret dhe dyshemeja duhet të sigurohen me të gjithë aksesorët dhe pajisjet për montimin e pajisjeve, dritareve për ajrim, si dhe hapësirat për hyrje-daljen e kablove dhe sistemin e tokëzimit.



Çatia (soleta)

Çatia ka të njëjtin ndërtim si trupi, me strukturë monolite prej hekuri-betoni me cilësi shumë të lartë (marka sipas llogaritjeve), me hekur me qëndrueshmëri të lartë, e derdhur sipas metodës zanore, dhe vendoset mbi muret e trupit.

- Çatia sigurohet në udhëzuesit e qosheve të trupit të kabinës me anë të elementeve fleksibël, të cilët eliminojnë nxehtësinë e mureve anësore.
- Përgjatë perimetrit të trupit të kabinës, midis çatisë dhe mureve, lihen vrima për ftohje.
- Ujërat largohen nga çatia me anë të një ulluku me tub PVC d=70mm.
- Ngjyra përcaktohet sipas nuancave **RAL**.

Soleta duhet të llogaritet për të përballuar një peshë të shpërndarë në mënyrë uniforme prej **400 daN/m²** dhe të sigurojë një koeficient mesatar të transmetimit të nxehtësisë prej **3.1 W/oC m²**. Ajo duhet të jetë e fiksuar për të garantuar siguri dhe të ketë termoizolim. Gjithashtu, duhet të ketë një shtresë mbrojtëse hidroizolimi për mbrojtje nga shiu.

Bazamenti dhe Zona e Kablllove

Për vendosjen në tokë të kabinës BOX dhe për hyrjen e kablllove, duhet të ndërtohet një bazament parafabrikat që vendoset në tokë, sipas përmasave të kabinës BOX. Prodhuuesi duhet të sigurojë që, gjatë montimit të kabinës në bazament, të mos depërtojnë ujërat sipërfaqësore.

Midis kabinës BOX dhe bazamentit nuk parashikohet asnjë lidhje mekanike; megjithatë, prodhuuesi duhet të sigurojë një bashkim të fortë që parandalon çdo zhvendosje horizontale të kabinës dhe një sistem lidhjeje BOX-Bazament që garanton izolim të plotë ndaj ujërave.

Bazamenti është i mbrojtur nga uji dhe shërben si rezervuar për grumbullimin e vajit gjatë dëmtimeve të transformatorit në rast avarie. Ai është i veshur me një mbulesë rezistente ndaj vajit mineral. Bazamenti ndërtohet prej hekuri-betoni me cilësi shumë të lartë (marka C35) dhe lidhjet e tij janë të salduara për të qenë të padepërtueshme nga uji dhe gazrat. Ai llogaritet për të përballuar peshën e kabinës, përfshirë pajisjet dhe personelin.

Zona e kablllove përmbush funksionet e mëposhtme:

- Grumbullues i vajit gjatë dëmtimeve të transformatorit.
- Hapësirë për shtrirjen e kablllove midis pajisjeve të kabinës.
- Hyrja dhe dalja e linjave kablllore, të vendosura në mbajtëse kablllosh.

Për hyrjen e kablllove, janë parashikuar vrima të posaçme për kabllot TM dhe TU, të vendosura në të dy anët gjatësore.

Dyert

Dyert duhet të jenë të përmasave që lejojnë montimin dhe çmontimin e pajisjeve teknologjike (Tr. 100kVA, çelat TM, paneli TU). Ato lidhen elektrakisht me rrjetin e tokëzimit. Drejtimi i hapjes së dyerve duhet të jetë nga jashtë, me një kënd hapjeje prej të paktën 110°. Dyert pajisen me dry dhe dritare ajrimi.

Ato ndërtohen nga aliazh alumini me cilësi të lartë, i qëndrueshëm ndaj kushteve atmosferike. Kornizat ndërtohen gjithashtu prej aliazh alumini me trashësi 3 mm.


Kushtet që duhet të përmbushin dyert:

- Rezistencë ndaj harkut elektrik.
- Çelës me tre rrugë bllokimi.
- Mbyllje nga brenda me një levë (sistem paniku).
- Ventilim me elemente prej aliazh alumini dhe rrjetë çeliku për mbrojtje nga insektet.
- Lidhje elektrike të kanateve me kasën, me përçues bakri fleksibël (jo më pak se 25 mm²).

Dyert duhet të kenë shkallë mbrojtjeje **IP 33D** dhe të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare **EN 60529**, **EN 50102**, **IEC 60112**, dhe përmirësimet e tyre.

Ajrimi

Pajisjet për ajrim duhet të përmbushin të gjitha standardet përkatëse. (Ilustrimet dhe dimensionet janë orientuese.)



Zhaluzitë do të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare **EN 60529**, **EN 50102**, **IEC 60112** dhe përmirësimet e tyre ose ekuivalentet. Ato do të ofrojnë siguri dhe qëndrueshmëri edhe në kushtet klimaterike që mbizotërojnë në vend.

Zhaluzitë janë testuar për rezistencë ndaj harkut elektrik.

Ajrimi i kabinës (përveç derës) realizohet përmes dritareve (zhaluzive) me grila metalike. Ventilimi është llogaritur për një transformator 100 kVA dhe për një mjedis bregdetar me temperatura të larta gjatë stinës së verës.

Ajrimi duhet të sigurojë nxjerrjen e nxehtësisë në ngarkesën dhe temperaturën maksimale të ambientit. Zhaluzitë duhet të kenë shkallë mbrojtjeje **IP 33D** dhe të lidhen elektrikisht me rrjetin e tokëzimit.

Zhaluzitë duhet të garantojnë mbrojtjen e operatorëve dhe publikut të gjerë, sipas klasës **IAC-AB 20kA për 1 sekondë**.

Dyshemeja

Dyshemeja duhet të realizohet me strukturë monolite prej hekuri-betoni me cilësi shumë të lartë (marka e betonit **C45** ose më e lartë) dhe me hekur me qëndrueshmëri të lartë (të dyja përcaktuar nga llogaritjet).

Dyshemeja duhet të mbajë një ngarkesë statike dhe një ngarkesë dinamike (ngarkesa maksimale e lëvizshme), e cila mund të vendoset kudo dhe t'i përgjigjet peshës së transformatorit, pajisjeve për të cilat është projektuar, si dhe personelit për mirëmbajtje dhe punime.

- Ngarkesa statike nuk duhet të jetë më e vogël se **500 kg/m²**.
- Ngarkesa dinamike (ngarkesa maksimale e lëvizshme) duhet të arrijë deri në **3000 kg**.



Pikat e vendosjes së transformatorit duhet të pajisen me mbështetëse antivibruese për zvogëlimin e përhapjes së zhurmave.

Punimet e brendshme

Kabina duhet të jetë e përfunduar si nga brenda ashtu edhe nga jashtë.

- Të gjitha nyjet dhe bashkueset duhet të jenë rezistente ndaj ujit.
- Pjesa e brendshme e mureve dhe tavani duhet të lyhen me ngjyrë të bardhë.
- Pjesa e jashtme duhet të trajtohet me një shtresë plastike rezistente ndaj ujit, e bërë me kuarç pluhur dhe oksid, për të qenë e qëndrueshme në kushte atmosferike të ambientit.
- Ngjyra e mureve duhet të jetë **viza vertikale bardhe dhe kuqe** dhe soleta ngjyrë gri.

Hyrja e kablllove

Për hyrjen e kablllove TM, bazamenti është i pajisur me 2 copë bushing standard në çdo anë, të cilat janë shtrënguese në formë bajonete me vrima të veçuara me diametër $d=150d = 150d=150$ mm. Ato janë të destinuara për përfshirjen e tyre në korpus dhe janë gati për montimin e kablllove. Furnizimi përfshin 2 copë bushing me tre vrima të veçuara në çdo anë, duke përfshirë edhe mëngët mbyllëse hermetike. Në gjendjen para montimit të kablllove, bushing-et dhe vrimat janë të mbyllura hermetikisht, duke mos lejuar depërtimin e ujit dhe lagështisë brenda bazamentit. Vrimat e veçuara duhet të përshtaten për kablllo me diametër të jashtëm minimal prej 15 mm dhe maksimal prej 55 mm. Birat e përdorura për kalimin e kablllove, pas futjes së tyre në bazament, duhet të sigurojnë përsëri mbyllje hermetike, duke parandaluar depërtimin e ujit dhe lagështisë brenda bazamentit. Për hyrjen e kablllove TU, bazamenti është i pajisur me një grup prej 8 shtrënguesish standard në çdo anë, të gatshëm për montimin e kablllove. Në gjendjen para montimit të kablllove, vrimat janë të mbyllura hermetikisht, duke mos lejuar depërtimin e ujit dhe lagështisë brenda bazamentit. Pesë nga vrimat e veçuara duhet të përshtaten për kablllo me diametër të jashtëm minimal prej 15 mm dhe maksimal prej 55 mm, ndërsa tre vrima duhet të përshtaten për kablllo me diametër të jashtëm minimal prej 20 mm dhe maksimal prej 110 mm. Birat e përdorura për kalimin e kablllove, pas futjes së tyre në bazament, duhet të sigurojnë mbyllje hermetike, duke parandaluar depërtimin e ujit dhe lagështisë brenda bazamentit.

Mund të pranohet edhe një zgjidhje alternative për hyrje-daljen e kablllove, me kusht që të respektohet numri i kablllove i përmendur më sipër dhe që hermeticiteti të garantojë mbrojtjen nga depërtimi i ujit dhe lagështisë brenda bazamentit.

Instalimi i Kabinës në Site

Për instalimin e kabinës në terren, duhet të gërmohet një gropë drejtkëndore, duke marrë parasysh dimensionet e sakta të kabinës të përcaktuara nga prodhuesi. Në vizatime, dimensionet janë orientuese.

Pas gërmimit, toka duhet të ngjeshet me pajisje të posaçme. Gropa duhet të mbushet me një shtresë zhavorri 6–8 mm, me trashësi **100 mm**, e cila duhet të ngjeshet mirë. Përreth gropës duhet të realizohet një sistem drenazhimi. Miratimi përfundimtar për qëndrueshmërinë e tokës duhet të jepet nga një përfaqësues i autorizuar i **Albcontrol**.

Të gjitha strukturat metalike dhe pajisjet fiksuese duhet të jenë prej materiali antikorroziv ose çeliku të galvanizuar.



Dyert duhet të sigurohen me mekanizëm kyçës prej bronzi të kromuar. Të gjitha instalimet e jashtme duhet të fiksohen në mënyrë të tillë që të çmontohen vetëm nga brenda dhe të jenë të sigurta nga vjedhjet e mundshme.

Shenjat e sigurimit teknik dhe pengesat

Në dyert e kabinës së transformatorit (përfshirë ambientin e transformatorit me vrimat e ventilimit) vendosen tre tabela sigurie teknike me përmbajtjen e mëposhtme:

1. Tabela tip 1

- Shenja: Rrufé
- Shënimet: *"Tension i lartë – Rrezik vdekje!"*
"Mos prek, rrezik vdekje!"

2. Tabela tip 2

- Shenja: Fushë uji që derdhet në zjarr
- Shënimi: *"Të mos shuhet me ujë ose me pajisje me shkumë!"*

3. Tabela tip 3

- Shënimi: *"Ndalohej hyrja!"*

Pas hapjes së dyerve të ambienteve të transformatorëve, për të ndaluar hyrjen, vendosen dy pengesa të kuqe.

Në vende të përshtatshme të paneleve TM/TU janë vendosur gjithashtu shenja të tjera sigurie teknike, në përputhje me standardet dhe rregulloret përkatëse.

5.2.5 Instalimet elektrike për ndriçim të brendshëm dhe të jashtëm

Instalimet elektrike realizohen me tuba plastikë të inkorporuar në konstruksionin e ndërtesës dhe përfshijnë:

- Përçues të izoluar me seksion $4 \times 2.5 \text{ mm}^2$
- Dy priza 240V/16A të inkastruara.
- Çelësa të inkastruar.
- Ndriçues dhe një miniautomat.


Të gjitha pajisjet dhe aksesorët duhet të jenë të izoluar dhe të garantojnë:

- Mbrojtje nga prekja e rastësishme.
- Mbrojtje nga zjarri.

Shkalla minimale e mbrojtjes për pajisjet dhe aksesorët nuk duhet të jetë më pak se **IP 54**.

Sistemi i tokëzimit

